



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 21 prot.

Kamëz, më 19 . 02 .2021

V E N D I M

Nr. 18 Datë 19 . 02 .2021

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORET SHOQERORE PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.02.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.18 Datë 15.02.2021**, mbështetur në Ligjin 57. Date 18.07.2019”Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kritereve , të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri ne 6%” të ndryshuar dhe VKM 597 dt., 04.09.2019 kreu 4 pika 3 “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. Dhe në VKB nr 158 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e kritereve për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit **Këshilli Bashkiak Kamëz** :

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së muajit **Janar**, prej 47 familjeve që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është **168,560 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë, e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë**.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/Kryetar Këshilli

Ali DAUTI